*Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo*

*Komuna – Suharekë / Opština Suva Reka / Municipality of*

07-07-22

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

| MARRË NË DORËZIM - PRIMLJENO - RECEIVED | | | |
|---|---|---|---|
| Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit | Numri Broj Number | Shtojca Prilog Appendix | Vlera Vrednost Value |
| 01 | 016 | 40510 | 2 |

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E SUHAREKËS • REPUBLIKA KOSOVA • OPŠTINA SUVA REKA • REPUBLIC OF KOSOVA • THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

*PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE*

***Të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021***

| NR | Komponent a e auditimit (kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë | Zyrtarët përgjegjës | Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit Çështja A1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike | Gjetja<br>Neni 18, paragrafi 3, i Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike", përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël.<br>Bazuar në testet e kryera rezulton se kishte raste të | Rekomandimi A1<br><br>Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/ kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ri destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate | Ne në vijim do të forcojmë kontrollin gjatë planifikimit te buxhetit të planifikohen aq sa është e mundur që ndarjet buxhetore të planifikohen , shpenzohen , regjistrohen sipas kategorive adekuate gjithnjë në mbështetje të paragrafit 3 të nenit 18 të rregullës financiare nr 01/2013.<br><br>Planifikimi i buxhetit procedohet sipas nevojave dhe kërkesave buxhetore të buxhetuara nga qytetarët andaj do të bashkëpunojmë me Ministrin e financave të siguroj legjislacion se të gjitha shpenzimet që konsiderohen si keqklasifikim të regjistrohen sipas kodeve në raport me natyrën e | **Zyrtarët për planifikim të buxhetit të të gjitha programeve buxhetore dhe Ministria e financave.** | 31.12.2022 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *klasifikimit jo të duhur të shpenzimeve si në vijim:<br>-Shpenzimet për softuer, fotokopje dhe tavolina, në shumën 25,000€, ishin regjistruar në kategorinë mallra & shërbime në vend që të klasifikohen në kategorinë e investimeve kapitale;<br>-Shpenzimet për projektin "Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve nga bora", në shumën 65,000€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të klasifikohen tek mallra & shërbime;<br>-Shpenzimet për projektin "Ndërtimi* | | *shpenzimeve.* | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *i serave për fermerë", në shumën 61,780€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në kodin ekonomik investime në vijim, në vend që të klasifikohen tek subvencione & transfere; dhe*<br>*-Shpenzimet për projektin "Rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për bagëti të fermerëve", në shumën 58,271€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në kodin ekonomik investime në vijim, në vend që të klasifikohen tek subvencione & transfero*<br><br>*Keqklasifikimet kishin ndodhur për shkak se këto shpenzime ishin planifikuar dhe* | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | buxhetuar gabimisht. | | | | | |
| 2 | Çështja A2 - Prezantimi/shpalosja jo e saktë e detyrimeve kontingjente në PFV | Sipas Rregullores MF nr. 01/2017, Neni 3 pika 1.1. Detyrim kontingjent - është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen; dhe Neni 18 Organizatat buxhetore në harmoni LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.<br><br>Në raportin vjetor financiar ishin shpalosur detyrime kontingjente në shumë 509,356€, mirëpo kjo shumë është e pasaktë për shkak të përfshirjes edhe të dy rasteve | **Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për detyrimet kontingjente në mënyrë që prezantimi i tyre në pasqyra financiare të jetë i saktë. | Ne në vijim do të forcojmë kontrollin që të gjitha detyrimet kontingjente të i shpalosim në mënyrë të drejtë të plotë dhe të saktë për raportime financiare në PVF. Shuma prej 44.125.00 nuk është përfunduar edhe ma tutje është në proces dhe në mënyrë të drejte e kemi prezantuar si detyrim kontingjent për raportime financiare. Andaj mbivlerësimi i detyrimeve duhet të jetë vetëm në vlerë prej 22.560.00 i cili si rast është i përfunduar.<br><br>Në vijim do të prezantohen në raportime financiare të gjitha detyrimet të cilat janë në proces dhe të pa përfunduar në mbështetje te nenit 3 pika 1.1 dhe nenit 18 për raportimet e detyrimeve kontingjente të rregullores nr 01/2017 Rregullores | Avokati i komunës dhe ZKF-ja | 31.12.2022 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *të përfunduara (22,560 dhe 44,125€), që rezulton me mbivlerësim të detyrimeve kontingjente për 66,685 .*<br><br>*Përfshirja e detyrimeve që janë të ekzekutuara tek shpalosja e detyrimeve kontingjente ka rrjedhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtarët tëcilët mbajnë evidencat lidhur më detyrimet kontingjente dhe nga pamjaftueshmëria e kontrollit të brendshëm.* | | | | | |
| 3 | *Çështja B1 - Dobësitë në regjistrimin e pasurive* | ***Gjetja***<br><br>*Neni 6 i rregullës MF nr.01/2017 për Raportimin vjetor* | ***Rekomandimi B1***<br><br>*Kryetari duhet të sigurojë se, të gjitha pasuritë e Komunës* | *Ne kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme pas daljes në pension të zyrtarit të pasurisë për lejimin e qasjes në sistem të* | *Thesari ,MAP dhe zyrtarët e pajisur me fjalëkalim.* | *Data e përfundimit në kohen e përshtatshm e para përgatitjes* | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *financiar nga OB përcakton që - Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.*<br><br>*Pasuritë kapitale jo financiare të blera gjatë vitit 2021, ishin në shumën 4,952,209€, ndërsa në regjistrin e përgjithshëm të pasurive kapitale ishin regjistruar 3,987,296€ me një diferencë prej 964,912€.*<br><br>*Përveç kësaj, shuma e pasurive nën 1,000€ të shpalosur në pasqyra financiare* | *janë identifikuardhe regjistruar saktë në regjistrat e pasurisë kapitale dhe jo kapitale duke pasur parasysh edhe përllogaritjen e zhvlerësimit.* | *menaxhuar nga thesari për regjistrimin e të gjitha pasurive kapitale jo financiare dhe qasje në sistemin e-pasuria për regjistrimin e pasurive jo kapitale dhe jo financiare deri më tani asnjë zyrtarë nuk iu është lejuar qasja dhe pajisur edhe me fjalëkalim .*<br><br>*Tutje nga Ministria përkatës ky sistem nuk ka edhe më tutje implementues të sistemit e-pasuria nga ndërprerje e kontratës dhe pritjet janë se mos lejimi i qasjes se zyrtareve të pasurisë do të vazhdoj edhe në vijim ne mos regjistrim të pasurive .*<br><br>*Ne mendojmë se lejimi i qasjes se zyrtareve të pasurisë në vijim,veprimet do të jenë efikase në regjistrimin e pasurive të grumbulluara deri më tani dhe blerjet për vitin aktual të regjistrohen ne mënyrë sistematike në pajtueshmëri me rregullat që rrjedhin nga UA 02/2013 për menaxhimin e pasurive .* | | *së pasqyrave vjetore financiare 30 01.2023* | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ishte 2,471,025€, ndërsa në regjistrin e përgjithshëm të pasurivenë vlerën 2,7124,845€, duke u nënvlerësuar ato për 253,820€.<br><br>Mos regjistrimi i plotë i pasurive kishte ardhur si pasojë që zyrtari i caktuar për pasuri (pas pensionimit të zyrtarit të pasurive, më 24 dhjetor 2021) nuk i'u kishte dhënë qasja në Sistem nga Thesari, deri në kohën e kryerjes së auditimit më 10 maj 2022. | | | | | |
| 4 | 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë<br><br>Çështja A3 - | Gjetja<br>Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, në nenin 20.10 parasheh që, specifikat | Rekomandimi A3<br>Kryetari duhet të sigurojë që, hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para | Ne në vijim për kontratat e punës pos specifikimeve teknike të cilët përcaktojnë natyrën dhe karakteristikat e përformancës të punëve të kërkuara si pjesë substanciale te vetën do të përgatisim edhe një projekt | Zyrtarët - Projektuesit e përgatitjes së paramasave dhe parallogarite. | Fillimi Gusht 2022<br><br>-Mbarimi Dhjetor 2022. | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Mos hartimi i projekteve ekzekutiv për projektet kapitale* | *teknike për kontratën e punës duhet të përfshijnë një projekt ekzekutiv si pjesë substanciale të veten.*<br><br>*Për projektet si më poshtë nuk ishte zbatuar kërkesa ligjore që, për secilën kontratë të punës duhet të hartohet një projekt ekzekutiv (për këto projekte ishin përgatitur vetëm paramasat dhe parallogaritë):*<br><br>*-Projekti "Ndërtimi i rrugëve lokale: Bubulina; Xhavit Kelmendi; Milaim Bugari; Shaban Polluzha dhe rrugë tjera lokale Suharekë", në vlerë prej 137,399 ;*<br>*-Projekti "* | *inicimit të procedurave të prokurimit.* | *ekzekutues.Të gjitha këto veprime do të realizohen para inicimit të çdo aktiviteti të prokurimit (Kontratë pune).* | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Rregullimi dhe sanimi i rrugëve lokale", në vlerë prej 96,811 ;<br>-Projekti "Ndërtimi i rrugëve lokale në lagjen Boka – vazhdim; ndërtimi i rrugës në lagjen Qarri – Esat Qarri – Grajqevc", në vlerë prej 26,301€.<br><br>Sipas zyrtarëve përkatës, me qëllim të mos vonesës së procedurave të prokurimit nuk ishin hartuar projektet ekzekutive. | | | | | |
| 5 | Çështja A4 - Mos pagesa e faturave brenda afatit 30 ditë | **Gjetja**<br>Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra | **Rekomandimi A4**<br><br>Kryetari duhet të sigurojë që, obligimet të planifikohen/ buxhetohen dhe | Ne në vijim do të forcojmë kontrollin që pas miratimit të kërkesës fillestare do të i zotojmë fondet e mjaftueshme për çdo furnizim/shërbim dhe punë që do të gjeneroj që pas | Autorizuesi i shpenzimeve dhe departamentet e financave të programeve buxhetore. | -Fillimi Gusht 2022<br><br>-Mbarimi Dhjetor 2022 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.*<br><br>*Nga analiza e data bazës së furnitorëve (lista e marrë), kemi vërejtur se gjatë vitit 2021, ishin kryer pagesa në shumën 1,058,033€ apo 2,010 raste të pagesave ndaj furnitorëve, të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh deri në dy vite.*<br><br>*Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave* | *paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë* | *pranimit të faturës të gjitha detyrimet te ekzekutohen në afatin e paraparë Ligjor.* | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *brenda afatit kohorë ligjor, që kanë rezultuar edhe me pagesa përmes vendimeve gjyqësore/ përmbarimore* | | | | | |
| *6* | ***Çështja A5 - Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve*** | ***Gjetja*** <br><br> *Sipas nenit 20 pika 3.1 të Rregullores MF nr. 04/2017 – Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve parashihet që, aplikuesit të ofrojnë dëshmi se kanë kryer të gjitha obligimet tatimore dhe kontributet pensionale sipas legjislacionit në fuqi; ose në rast të ekzistencës së detyrimeve, aplikuesit të ofrojnë një marrëveshje me autoritetet tatimore për përmbushjen e* | ***Rekomandimi A5*** <br> *Kryetari duhet të sigurojë që, Komisioni për vlerësim të aplikacioneve dhe përzgjedhje të përfituesve të subvencioneve të zbatojë të gjitha kriteret e parapara në thirrjen publike dhe në asnjë rast mos të tejkalohet pa dëshmitë për kryerjen e obligimeve tatimore dhe pensionale ndaj Administratës Tatimore.* | *Ne në vijim do të forcojmë kontrollin që komisioni për vlerësimin e ofertave gjatë vlerësimeve dhe ekzaminimeve , aplikuesit pos kritereve tjera të përcaktuar njëra ndër to është që të i plotësoj kushtet të përcaktuara si nën nenin 20 pika 3.1. Komisioni vlerësues do të ekzaminoj vlerësoj dhe krahasoj se aplikantët kanë ofruar dëshmi bindëse se nuk kanë obligime tatimore dhe kontribute pensionale të pa shlyera sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës ose në rast se kanë detyrime të pa shlyera të sigurohet dëshmia e një marrëveshje me autoritetin tatimore për shlyerjen e detyrimeve ekzistuese.* | *Komisioni vlerësues për vlerësimin e ofertave të aplikanteve për mbështetje financiare.* | *Fillimi shtator 2022* <br><br> *Përfundimi* <br><br> *31.12.2022* | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *detyrimeve të tilla.*<br><br>*Bazuar në testet e kryera rezulton se, katër OJQ ª fituese të subvencioneve janë përzgjedhur pa i plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara si: dëshmitë për kryerjen e obligimeve tatimore dhe pensionale ndaj Administratës Tatimore. Shuma vjetore e këtyre katër përfituesve të subvencioneve në total ishte 20,500 .*<br><br>*Kjo ka ndodhur nga neglizhenca e komisionit të vlerësimit të cilët nuk kanë marrë parasysh kërkesat e rregullores me rastin e vlerësimit dhe ndarjes së subvencioneve dhe transfereve.* | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | Çështja A6 - Mos marrja e pëlqimit paraprak për projektin në fushën e teknologjisë së informacionit dhe kontraktimi i shërbimit të përfshirë në kontratën e AQP-së | *Gjetja*<br>*Rregullorja nr. 06/2018 - Për menaxhimin e projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, në nenin 6.3 parasheh që, për inicimin e projektit institucionet marrin pëlqim paraprak nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI). Përveç kësaj, Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) kishte një kontratë të nënshkruar për "Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera – Niveli lokal – Lot III".* | ***Rekomandimi A6***<br>*Kryetari duhet të sigurojë që, para investimeve në teknologjinë e informacionit të marrë pëlqimin nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, si dhe në rastet e kontratës aktive të Agjencisë Qendrore të Prokurimit për shërbime për nivelin lokal ta zbatoj atë.* | *Ne në vijim nëse kemi objektiva për planifikimin e projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ,para inicimit të projektit do të i zbatojmë të gjitha standardet dhe rregullat unike që rrjedhin nga Rregullorja(QRK) nr. 06/2018 për menaxhimin e projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Ideja e projektit do të zhvillohet para fazës së inicimit të projektit i cili përmban edhe informata tekniko-ekonomike të projektit .Ne do të zbatojmë edhe rregullat që që rrjedhin nga pika 3 e nenit 6 te kësaj Rregullore që do të thotë që për idenë e projektit e inicimin e projektit do të marrim paraprakisht pëlqimin paraprak nga Agjencia e shoqërisë së informacionit(ASHI) dhe për blerjen e softuerëve dhe pajisjeve tjera të informacionit për shërbime te skanimit do të planifikojmë në kontratat e parashikuara çmimet e tregut* | *Drejtoria qe kanë nevojë për këto projekte .* | 31.12.2022 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Komuna kishte lidhur kontratë për "Blerjen e softuerit për menaxhimin e performancës dhe softuerit për digjitalizimit të arkivës", në vlerë 44,250€, pa marrjen e pëlqimit paraprak nga ASHI.*<br><br>*Përveç kësaj, kjo kontratë përfshinë edhe shërbimin e skanimit me çmim 0.04€/ për faqe, ndërsa sipas Kontratës së AQP-së, shërbimi i skenimit ishte i kontraktuar me çmimin 0.0061€/ për faqe. Duke analizuar dhe krahasuar numrin e faqeve për skanim të kontraktuar prej Komunës, për 556,125 faqe ishte 22,245€, ndërsa sipas kontratës së AQP-së një shërbim* | | *dhe çmimet e kontratave të vitit paraprak e nëse e lejojnë çmimet e tregut konkretisht nga AQP qe ka kontrata për komuna për këtë fushë e në veçanti në fushën e skanimit nëse jonë ma të ulëta se çmimet e tregut lokal.* | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *i tillë në vlerë financiare do të ishte 3,392€, ku do të realizohej një kursim prej 18,852 .*<br><br>*Sipas zyrtarëve të Komunës, kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së njohurisë për kërkesat të tilla.* | | | | | |
| 8 | **Çështja A7 – Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit** | *Gjetja*<br>*Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, neni 32.1, për një aktiviteti të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të shfrytëzojë procedurën e hapur ose procedurën e kufizuar. Nëse një dispozitë e neneve 34-37 të këtij ligji shprehimisht autorizon* | *Rekomandimi A7*<br>*Kryetari duhet të sigurojë që, inicimi i aktiviteteve të prokurimit bëhet në kohë dhe përdorim të duhur të procedurave të prokurimit.* | *Ne në vijim nëse është e hevojshme do të aplikojmë procedurat e prokurimit të negociuara pa publikim të kontratës vetëm me një operator të cilit do të i ipet edhe kontrata në pajtueshmëri me neni n 35 të Ligjit të prokurimit për llojet e kontratave- nëse për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike të natyrës artistike, të mbrojtjes së drejtave intelektuale apo industriale si dhe raste të nevojave të emergjencës ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarjet natyrore ose ekuivalente objektivisht të verifikueshme* | *Njësit e kërkesave dhe zyra e prokurimit.* | *Fillimi Gusht 2022*<br><br>*Mbarimi 31.12.2022* | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *shfrytëzimin e një procedure tjetër prokurimi, autoriteti kontraktues mund të shfrytëzojë atë procedurë ose procedurën e hapur. Ushtrimi i një procedurë të prokurimit duhet të bëhet në pajtim të plotë me dispozitat e zbatueshme të këtij ligji.*<br><br>*Kontrata "Inventarizimi i Shtëpisë Muze Fadil Vata në Sallagrazhdë", me vlerë 21,999€, është kontraktuar përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me ftesë të tre operatoreve ekonomik duke u thirrur në nenin 35* | | *si dhe kontrata tjera ekuivalente.*<br><br>*Për kontratat e nënshkruar do të sigurojmë se çmimet e kontraktuara nuk janë ma të larta se çmimet përkatëse të tregut në pajtueshmëri me normat ligjore që rrjedhin nga Ligji i prokurimit.* | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | paragrafin 2.1 të LPP-së, ndërsa do të duhej të realizohej përmes procesit të rregullt të prokurimit me procedurë të hapur.<br><br>Sipas zyrtarëve të Komunës kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së planifikimit të aktivitetit të prokurimit | | | | | |
| 9 | Çështja B2 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë | **Gjetja**<br>Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcaktonse, personi fizik i cili vendos se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor (për të cilën e deklaron në Komunë), i lejohet zbritja prej 15,000 nga vlera e vlerësuar e njësisë | **Rekomandimi B2**<br><br>Kryetari të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim | Edhe përkundër një progresi për faturat e printuara ne vitin 2022, Menaxhmenti do të forcoj kontrollin që në bashkëpunim me mirëmbajtësit e softuerit të- pro –tax-it në rregullimin e informacioneve në mënyrë që faturimi të jetë i saktë<br><br>Në vijim po ashtu zyra e tatimit në pronë do të veproj edhe më tutje në njoftimin dhe sensibilizimin se pësoni fizik qe ka në pronësi ma shumë se një objekt banimi | - Zyra e tatimit në pronë.<br><br>-Departamenti i tatimit në pronë | Faza e parë TM2 2022<br><br>Dhe përfundim i para fillimit të printimit dhe shpërndarjes se faturave të tatimit në Pronë | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *së objektit. Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit nëPronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/ apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.*<br><br>*Për 2,382 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 – "Zbritjet për vendbanim parësor", mirëpo* | *tjetër eventual.* | *duhet te vendos deri me 30 nëntor para vitit tatimor se cila njësi e objektit i shërben se vendbanim parësor dhe e deklaron në zyrën e tatimit në pronë dhe i lejohet zbritja nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Neni 11 pika 1 të Ligjit për tatimin e pronës së paluajtshme.*<br><br>*Zyra e tatimit në pronë është në proces të identifikimit të pronave që personi fizik që posedon ma shumë se një objekt të banimit dhe bënë korrigjimin e faturave.* | | *Janar 2023* | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, ku për pasojë rezulton më pak të hyra nga tatimi në pronë për rreth 53,595€.*<br><br>*Përveç kësaj, zbritja primare ishte zbatuar ndaj 213 tatimpaguesve, të cilët kanë në posedim prona rezidenciale më shumë se një pronë, zbritje e cila rezulton më pakë të hyra nga tatimi në pronë për rreth 4,792€.*<br><br>*Sipas konfirmimeve zyrtare, kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake, mirëpo për faturimet e vitit 2022, për tatimpaguesit që nuk* | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kanë numër personal të evidentuar dhe të cilët nuk e kanë deklaruar "Banimin Parësor" nuk do të zbatohet zbritja e lejuar. | | | | | |
| 10 | 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë<br><br>**2.3.1 Të arkëtueshmet Llogaritë e Arkëtueshme (LLA) janë prezantuar në PFV në vlerë prej 5,880,5** | *Gjetja*<br><br>Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës së Suharekës, në nenin 3.3 përcaktohet që, në rast të vonesës së pagesës së qirasë, qiramarrësi do të ndëshkohet konform kamatave bankare të cilat janë në fuqi.<br><br>Testet e kryera në lidhje me zbatimin e ndëshkimeve | **Rekomandimi B3**<br><br>Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e të arkëtueshmeve dhe të zbatojë mekanizimat ligjor të mbledhjes së tyre. | Ne në vijim do të forcojmë kontrollin dhe do të krijojmë mekanizma adekuat në ndërmarrjen e veprimeve bazuar ne Rregullat qe rrjedhin nga Kapitulli VII neni 26 të Për tatimin mbi pronën e paluajtshme dhe nenit 5 pik 5.2.12 për të hyrat jo tatimore. Po ashtu për qiramarrësit për shfrytëzim të tokës ndërtimore për vonesë evneteuale do të kalkulojmë ndëshkimet mbi bazën e rregullave që rrjedhin nga pika 3.3 të kontratave të nënshkruar. | Zyrtaret e autorizuar dhe përgjegjësit e tatimit në pronë dhe sektorit te financave. | Fillimi i implementimit Gusht 2022 dhe vazhdon deri më TM4 2023 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 26€.<br>Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë, tatimi në tokë, taksa e biznesit, shfrytëzimi i pronës publike etj<br><br>Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e të arkëtueshmeve | konform kamatave bankare ndaj qiramarrësve, në rast të vonesës së pagesës së qirasë, rezulton se në dy raste nuk ishin zbatuar ndëshkimet edhe pse ka pasur vonesa të pagesës së qirasë nga qiramarrësit.<br><br>Përveç kësaj, llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë, qiratë dhe nga taksat në aktivitete të biznesit kanë një trend të rritjes, për të cilat nuk janë ndërmarrë veprimet ligjore për inkasimin e tyre.<br><br>Sipas zyrtarëve të Komunës, të | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | arkëtueshmet e grumbullura ndër vite (borxhe të vjetra), si dhe gjendja financiare e bizneseve dhe qytetarëve për t'i realizuar obligimet ndaj Komunës, ishte një ndër shkaqet kryesore për mbledhjen e të arkëtueshmeve. | | | | | |
| 11 | 2.3.2 **Detyrimet e papaguara** Pasqyra e detyrime ve në fund të vitit 2021, ishte 85,783€. Këto detyrime janë bartur për t 'u paguar | Gjetja<br>Rregulla financiare nr. 01/2013 për Shpenzimin e parave publike, në nenin 24 për pranimin dhe pagesën e faturës, ndër të tjera parasheh që të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëmpër qarkullim të | **Rekomandimi A8**<br>Kryetari duhet të sigurojë që, mos të pranohen faturat pa u siguruar paraprakisht raportet e pranimit të mallit/ shërbimit, si dhe të merren veprimet e | Edhe përkundër se për këtë proces ka progres forcimi i kontrollit te brendshëm në zbatimin e procedurave se çdo faturë duhet të pranohet duke i zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit. Një menaxhim i mirë i këtij procesi do të gjeneroj se asnjë faturë nuk do të pranohet pa siguruar paraprakisht raportin e pranimit të mallit/ shërbimit nga komisioni për pranim të mallit/shërbimit si dhe | Autorizuesi i shpenzimeve dhe departamentet e financave projekteve buxhetore dhe Zyrtari certifikues. | Fillimi Gusht 2022<br><br>Mbarimi 31.12.22 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | në vitin 2022.<br><br>Çështja A8 - Pranimi i faturave, pa raport të pranimit për shërbimin e kryer | dokumentacionit si: të siguruarit e raportit të pranimit të mallit/ shërbimit nga zyrtari/ komisioni i autorizuar.<br><br>Për projektet "Lot 1 – Projektet për parandalimin e vërshimeve në Suharekë dhe Lot 2 – Varrezat e qytetit" dhe "Trajtimi i qeneve endacak" ishin pranuar faturat të listuara në listën e obligimeve, me shumat përkatëse 20,200€ dhe2,508€, pa u siguruar paraprakisht raporti i pranimit të shërbimit (situacionit) nga të autorizuarit.<br><br>Sipas Komunës, pranimi i faturave pa siguruar paraprakisht raport | duhura për faturat e pranuara pa raport pranimi përfshirë mospagesën e tyre. | procedurat tjera që rrjedhin nga neni 24 "Pranimi dhe pagesa e faturës" duke filluar nga pikat 1.1-1.7 të Rregullit financiar nr 01/2013-Shpenzimi i parave publike që do të thotë se dokumentacioni i kompletuar dërgohet për pagesë ,procedohet ,paraprakisht pasi të jetë e autorizuar fatura për pagesë nga Zyrtari certifikues. | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të pranimit të shërbimit (situacionit) nga të autorizuarit është bërë si pasojë e mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme. | | | | | |

*Duke marrë në konsiderate Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA-së), në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit jemi zotuar për adresimin dhe zbatimin e rekomnadimeve të dhëna sipas Planit të Veprimit.*

*Së bashku me Kryesuesin e Kuvendit të komunës do të harmonizojmë agjendën e takimit për shqyrtimin e Raportit të Auditmit në mbledhjen e radhës së Kuvendit dhe shqyrtimin e planit të veprimit për adresimin dhe zbatimin e rekomandimeve.*

- *Deri në fund të muajit janar 2023, do të diskutoj në Kuvendin e Komunës për progresin lidhur me zbatimin e rekomandimeve te adresuar në Planin të Veprimit , para se Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit 2022 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Transereve;*
- *Po ashtu, në kohë reale do të dorëzojmë Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.*
- *Me planin e veprimit të njoftohen të gjithë bartësit të autorizuar për adresimin e rekomandimimeve në formë elektronike.*

***Veprimet e Kryetarit të komunës dhe ndermarrja e veprimeve në adresimin dhe zbatimin e rekomandimeve janë si në vijim:***

***Njoftohen dhe obligohen të gjithë bartësit e përcaktuar që menjëherë të fillojnë me përcjelljen e implementimit të procedurave të projektuar për adresimin e tërësishëm të rekomandimeve sipas afateve të caktuar në planin e veprimit të Menaxhmentit.***

***Për mënyrën, afatin e jetësimit të rekomandimeve të gjithë bartësit e përcaktuar janë të obliguar më kohë dhe në mënyrë të detajuar në formë të shkruar të na raportoni. Ne në vijim do të vlerësojmë ecurit e progresit dhe dobësitë eventuale sipas periudhave tremujore. Pos raportimeve më shkrim do t'i zbatojmë procedurat e vetëvlerësimit lidhur me progresin e arritur dhe do t'i identifikojmë dobësitë që kanë***

*rezultuar në mos adresimin e rekomandimeve dhe vendosjen e kontrollave dhe mekanizmave efikase të adresimit të plotë të rekomandimeve. Moszbatimi eventual i rekomandimeve të përcaktuar si më lartë në planin e veprimit të Menaxhmentit përgjegjësia bie mbi bartësit.*

Koordinatori i procesit

*Labinot Halitjaha*

*Kryetari i Komunës*

*Bali Muharremaj*

*Suharekë datë ; 07.07.2022*